

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS  
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU  
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

Nr./Prot./Br. Prot./Prot.No. 55/21-03  
Nr./Fol./Br. St./No.Pg. 1/5  
Data/Datumi/Date: 11.02.2021  
PRISHTINË-PRISTINA-PRISTINA



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS  
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU  
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo  
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije  
Ministry of Finance

Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo

ARKIV / ARHIVA / ARCHIVE

Njësia Org. \_\_\_\_\_ Nr. i Pro. \_\_\_\_\_  
Org. Jedin. Z-P Br. Pro. 09-06-741  
Mbledhja \_\_\_\_\_ Prot. Ie. \_\_\_\_\_

Nr. i faqeve \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_  
Broj. Stranica \_\_\_\_\_ Datum \_\_\_\_\_  
Mbledhja \_\_\_\_\_ Dite \_\_\_\_\_



Administrata Tatimore e Kosovës  
Poreska Administracija Kosova  
Tax Administration of Kosovo

# MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

ndërmjet

**AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURENCËS**

dhe

**ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS**

Prishtinë, Shkurt 2021

Palët e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (në tekstin e mëtejshëm: Memorandumi), Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: AKK) dhe Administratës Tatimore të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm ATK) nënshkruajnë këtë Memorandum në bazë të kompetencave të tyre sipas dispozitave të Legjislacionit në fuqi, me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta në fushat përkatëse që janë në fushëveprimin e këtyre dy institucioneve për zbatimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

## **Neni 1** **Dispozita të përgjithshme**

1. Ky Memorandum është hartuar për bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve ndërmjet Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK) dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) duke i marrë parasysh:
  - 1.1. Paragrafin 1 të nenit 61 dhe paragrafin 4 të nenit 63 të Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës;
  - 1.2. Dispozitat ligjore të nenit 84 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe Nr. 04/L-223.
2. Ky Memorandum shpreh vullnetin e lirë të palëve nënshkruese të këtij memorandumi për ta nxitur bashkëpunimin në fushën e hetimeve të shkeljes së Konkurrencës në Kosovë, dhe krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe, bazuar në parimet e barazisë dhe të përfitimit reciprok.

## **Neni 2** **Synimi**

1. Ky Memorandum synon arritjen e ujdisë midis palëve nënshkruese për realizimin më të suksesshëm të misioneve të tyre të cilat përqendrohen në:
  - 1.1. Anën e AKK-së:
    - 1.1.1. Politikën e konkurrencës të bazuar në implementimin e rregullave për të siguruar garën reciproke dhe të ndershme të kompanive në treg, duke e inkurajuar ndërmarrësin dhe efikasitetin me qëllim të ofrimit konsumatorëve një zgjedhje më të gjerë e cila e ndihmon reduktimin e çmimeve dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe në
  - 1.2. Anën e ATK-së:
    - 1.2.1. Mbledhjen e tatimeve dhe kontributeve, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve të Kosovës, duke tentuar që të bëhen

gjithnjë e më të besueshëm dhe të respektuar, si dhe më të mirë krahasuar me administratat udhëheqëse tatimore në Evropë, gjithnjë duke zbatuar dispozitat e ligjit bazik për procedurat, Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale, Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Ligjit për Tatimin në Vlerën e Shtuar si dhe çdo legjislacioni tjetër që mund t'i ngarkohet për administrim të çfarëdo lloji tatimi.

### **Neni 3**

#### **Spektri i bashkëpunimit**

Nëpërmjet të këtij bashkëpunimi krijohen mekanizma të përshtatshëm institucional për të vepruar në parandalimin dhe eliminimin e çdo sjellje të ndërmarrjeve dhe ndërmarrësve e cila mund të ndikojë negativisht në paraqitjen e konkurrencës në treg në Republikën e Kosovës, dhe në pengimin e aktivitetit për mbledhjen e suksesshme të hyrave të pritshme qeveritare, kryesisht përmes përmbushjes vullnetare të detyrimeve të tatimpaguesve, sipas ligjeve tatimore të Kosovës, me qëllim të sigurimit të ofrimit të shërbimeve të rëndësishme qeveritare.

### **Neni 4**

#### **Aktivitetet e përbashkëta të palëve**

1. Për qëllime të zbatimit të këtij Memorandumi aktivitetet kryesore të përbashkëta të palëve mund të jenë:
  - 1.1.shkëmbimi i informacionit lidhur me formimin legjislativ dhe trajtimin e rasteve përkatëse me interes të përbashkët;
  - 1.2.Inkasimi i detyrueshëm i sanksioneve administrative të shqiptuara nga AKK, bazuar në procedurat administrativë të ATK-së
  - 1.3.shkëmbimin e përvojave në fushën e hetimeve, lidhur me shkeljen e rregullave të konkurrencës;
  - 1.4.shkëmbimin e përvojave lidhur me zhvillimin e marrëdhënieve midis Autoritetit të Konkurrencës, Agjencive kombëtare rregullatorë dhe Administratës Tatimore të Kosovës;
  - 1.5.takimet e ekspertëve ose konsultimet përmes e-mail-it në mese të ekspertëve të palëve lidhur me shkëmbimin e informacionit jo-konfidencial për çështjet specifike me interes të ndërsjellë;

### **Neni 5**

#### **Detyrimet e palëve nënshkruese**

1. AKK, në pajtim me përgjegjësitë që ka me dispozitat ligjore në fuqi, do të:
  - 1.1.Konsultohet dhe bashkëpunojë me ATK-në me rastin e kryerjes së hetimeve për shkeljen e konkurrencës, sipas Ligjit për mbrojtjen e Konkurrencës, i cili shprehet edhe në fushën e mbledhjes së tatimeve dhe kontributeve;

- 1.2.Nëse ndërmarrja, në afat nuk e bënë pagesën e masës së shqiptuar ndëshkuese ,Autoriteti njofton Administratën Tatimore të Kosovës, në zonën në të cilën banon respektivisht selinë e personit të dënuar, për të paguar shumën e masës ndëshkuese të shqiptuar administrative në mënyrë të detyrueshme sipas dispozitave për pagesën e tatimit. Masa ndëshkuese e cila në kërkesë të Autoritetit arkëtohet përmes mbledhjes se detyrueshme nga Administrata Tatimore shkon drejtpërdrejt në Buxhetin e shtetit.
  - 1.3. Informoj ATK-në me të gjitha ankesat e pranuar nga subjektet e ndryshme për dëmtimin e konkurrencës të cilat shprehen edhe në fushën e mbledhjes së tatimeve dhe kontributeve;
  - 1.4.Informoj ATK-në me rastin e fillimit të ndonjë hetimi në përputhje me dispozitat relevante të ligjeve në fuqi, ku kërkohet ndihma edhe e ATK-së.
  - 1.5.Merr parasysh rekomandimet e ATK-së kur një hetim apo studim i bazuar në Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës e përfshinë edhe fushën e mbledhjes së tatimeve dhe kontributeve. Në rast të mospajtimit, AKK duhet ta informoj ATK-në, duke i specifikuar qartë arsyet e mospajtimit;
  - 1.6.Informon ATK-në para marrjes së ndonjë Vendimi, në përputhje me dispozitat e ligjeve në fuqi, i cili e prek fushën e mbledhjes së tatimeve dhe kontributeve;
  - 1.7.Informon ATK-në nëse vërtetohet se sjellja e një ndërmarrje mund të ketë ndikim negativ në aktivitetin e mbledhjes së tatimeve dhe kontributeve;
  - 1.8.Informon ATK-në me rastin e paraqitjes së dukurisë së shkeljes së konkurrencës në tregjet e tjera e cila dukuri besohet se mund të ndikoj në fushën e mbledhjes së tatimeve dhe kontributeve;
2. ATK, në pajtim me përgjegjësitë që ka me ligjet tatimore në fuqi:
- 2.1 Pasi që pranon njoftimin zyrtar nga Autoriteti, bënë ekzekutimin e masës ndëshkuese administrative në mënyrë të detyrueshme sipas dispozitave të ligjeve në fuqi.
  - 2.2.Informon AKK-në lidhur me rastin e konstatimit të shkeljes së konkurrencës në fushën e aktivitetit të mbledhjes së tatimeve dhe kontributeve;
  - 2.3.Merr parasysh rekomandimet e AKK-së me rastin e trajtimit të një subjekti në fushën e mbledhjes së tatimeve dhe kontributeve, gjate të cilit ka ndodh edhe shkelja e rregullave të konkurrencës. Në rast të mospajtimit, ATK duhet ta informoj AKK-në, duke i specifikuar qartë arsyet e mospajtimit.
  - 2.4.Konsultoj dhe bashkëpunojë me AKK-në me rastin e hartimit dhe miratimit të Akteve normative me të cilat preket fusha e veprimit të mbrojtjes së konkurrencës.

## **Neni 6**

### **Dispozita përfundimtare**

1. Asnjë ndryshim nuk mund t'i bëhet këtij Memorandumi në mënyrë të njëanshme, përveçse me shkrim, dhe atë pasi palët të kenë rënë dakord paraprakisht midis tyre dhe ta kenë autorizuar ndryshimin nëpërmjet të nënshkrimit nga titullarët e palëve.

2. Ky Memorandum hyn në fuqi pas nënshkrimit nga AKK dhe ATK, dhe është i vlefshëm, deri sa palët nënshkruese të kërkojnë me shkrim shfuqizimin ose shuarjen e tij ose imponimin e dispozitave të reja ligjore të miratuara nga legjislativi i vendit.
3. Shfuqizimi në mënyrë të njëanshme i këtij Memorandumi mund të bëhet në çdo kohë, nga ana e AKK-së dhe ATK-së, duke e lajmëruar palën tjetër me shkrim 60 ditë më parë.
4. Memorandumi është hartuar dhe pranuar nga palët, duke nënkuptuar faktin se asnjë pjesë e tij nuk është në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore të cilat e rregullojnë aktivitetin publik të palëve nënshkruese.
5. Palët nënshkruese zotohen ta zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë Memorandum për sa parashikohet në të. Mosmarrëveshjet eventuale zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, secila nga palët mund të tërhiqet dhe të ndërpresë në mënyrë të njëanshme Memorandumin sipas mënyrës së paraparë në nenin 6 paragrafi 3.
6. Për lehtësimin dhe sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm për zbatimin e këtij Memorandumi, palët bien dakord që ti caktojnë personat dhe mënyrën e kontaktit midis tyre, në një afat kohor prej 30 ditëve nga dita e nënshkrimit.
7. Memorandumi i mirëkuptimit dhe i bashkëpunimit, është shkruar në gjuhën shqipe, në dy kopje nga një për secilën palë. Nënshkruhet dhe hynë në fuqi me datën e nënshkrimit.

Prishtinë: 11.02.2021

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës



Valon Prestreshi  
Kryetar i AKK-së

Administrata Tatimore e Kosovës



Ekrem Hysenaj  
u.d. Drejtor i Përgjithshëm